



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:160975

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05524385

P.nr.522/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, në çështjen penale kundër të pandehurve: E. R. nga Gjilan, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), dhe M. V. nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr...../2023, të datës 24.07.2023, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor me shenjën PP.II.nr...../2023, të datës 24.07.2023, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftuar për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me datë 29.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor me shenjën PP.II.nr.1073/2023, të datës 24.07.2023, andaj kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurve:

I.I pandehuri E. R., nga babai A., i lindur me datë, në fshatin P., Komuna e K., ku edhe jeton në Rr."M. B.", me numër personal, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. I pandehuri M.V., nga babai S., i lindur me datë, në P., me vendbanim në lagj. "A.", Rr. "T. T.", nr..., me numër personal, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I pandehuri E.R.:

I

Sepse me datë 13.Qershor 2023, rreth orës 21.00 min., në rrugën "Mulla Idrizi", në Gjilan i pandehuri E. R., me dashje dhe me përdorimin e atë qasshëm të dhunës, e ka sulmuar të pandehurin tani dëmtuarin M. V., ashtu që pas një mosmarrëveshje në mes tyre rreth rendit të përcaktuar nga vet taksistët, i dëmtuari M. V. veturën e tij Seat me targa 06-....-.. e parkon në parkingun e rezervuar për taksitë, duke mos i'u përmbajtur rendit të përcaktuar nga vet taksistët ashtu që bllokoi hyrjen e të pandehurit E. R., i cili ishte në veturën e tij dhe aty fillon mosmarrëveshja, ku i pandehuri ofrohet tek dera e veturës së të pandehurit tani të dëmtuarit M. i cili kishte dritaren e veturës të hapur, e me ç' rast i pandehuri E. R. përmes dritares e sulmon duke e goditur me grusht në fytyrë, kështu që i pandehuri me veprimet e tij, tek i dëmtuari ka shkaktuar dhembje, mundim, frikë dhe shqetësim të madh emocional.

-Me çka kanë kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së.

I pandehuri M. V.:

II

Sepse me datë 13.Qershor 2023, rreth orës 21.00 min., në rrugën "Mulla Idrizi", në Gjilan i pandehuri M. V. me përdorimin e atqasëshëm të dhunës, me dashje i shkaktonte lëndime trupore të pandehurit tani të dëmtuarit E. R., ashtu që pas një mosmarrëveshje në mes tyre rreth rendit të përcaktuar nga vet taksistët, ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e parë, pas sulmit që i është bërë nga i pandehuri –tani i dëmtuari E. R., i njëjti nga dritarja e veturës e godet dy herë më grusht në anën e djathtë të fytyrës, kështu që i pandehuri me veprimet e veta i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore te i dëmtuari E. R. në formë të ndrydhjeve te indeve te buta të regjionit te fytyrë, i cili për shkak të natyrës së lëndimeve është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit .

-Me çka ka kryer veprën penale, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 44,45,69,70,71, dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 493 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurve ju shqiptohet,

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që i pandehuri E. R., dënohet me dënim gjobë në shumë prej 200 (dyqind- euro) € të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ashtu që i pandehuri M. V., dënohet me dënim gjobë në shumë prej 200 (dyqind-euro) €, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të pandehurit refuzojnë të paguajë dënimin me gjobë ose nuk janë në gjendje ta paguajnë atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të pandehurit do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20 € (njëzet euro) ndërsa nëse të pandehurit nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet- euro) do të caktohet një ditë burgim.

Obligohen të pandehurit që secili veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (njëzetë- euro), në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurve: E. R. nga Gjilan, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës(KPRK-ës), dhe M. V. nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-ës, Gjithashtu Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimorë, sipas të cilit ndaj të pandehurve ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhrit ndëshkimorë ndaj të pandehurve të lartcekur dhe të pandehurve ju shqiptoi dënim me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor. Gjendja faktike vërtetohet përmes Raporti informues i incidentit nga Stacioni Policor në Gjilan nr.2023-CA-...., i datës 17.06.2023, deklaratat e të pandehurve M. V. dhe E. R., raporti fillestar i incidentit i datë 13.06.2023, raporti i oficerit, raporti mjekësor në emër të Enver Rudaku me nr.13786 i datës 13.06.2023, ekspertiza mjeko ligjore e datës 18 Korrik 2023 në emër të E. R., një (1) CD, si dhe shkresa të tjera të lëndës, vërtetojnë se të pandehurit e lartcekur kanë kryer veprat penale: sulmi nga neni 184 paragrafi 1 KPRK-ës, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore dhe ndaj të pandehurve, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Me datë 29.03.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi të pandehurit mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.